



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr.12, datë 14/05/2026

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIM TË LEJES/AUTORIZIMIT,
LIDHUR ME RINOVIMIN E LEJES NR. SERIAL 00012 “LEJE PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME
INDUSTRIALE/LAVAZH”, TË SUBJEKTIT “GENER 2” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujur, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovim të lejes/autorizimit, lidhur me rinovimin e lejes Nr. Serial 00012 “Leje për përdorim burimi ujur nëntokësor për qëllime industriale/lavazh”, të subjektit “GENER 2” sh.p.k, me vendndodhje: Rruga Murat Toptani, Qendra Tregtare Toptani, Bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH):

X= 485101.56 Y= 4576937.69 Z= 114 m.m.n.d

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për qëllime industriale, lavazh.

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q = 0.2 \text{ l/s}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL ISHËM

ADRIAN GURRA

